



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
NDËRMARRJA E PASURISË PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE

NR____prot

DATA:____/____/2026

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS – MALLRA

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE MATERIALE PËR SINJALISTIKËN RRUGORE”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Sinjalistikë rrugore 34992200-9; Tabela rrugore 34992300-0.

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 1,499,780(një milionë e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë)LEKË PA TVSH.

Vlera e fondit limit është pëllogaritur nga grupi i punës i ngritur me Urdhërin Nr.84.prot,datë 23.04.2026, për pëllogaritjen e fondit limit, hartimin e preventivit dhe specifikimeve teknike duke u bazuar në Vendimin Nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të cmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Vënë në dispozicion nga: Vetëfinancim.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti/enti kontraktor, Ndërmarrja e Pasurisë Publike, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 "Kriteret detyruese për skualifikim" Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertës", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të nenit 26 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP "1. *Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik*".

Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël".

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- EN-ISO 9001 2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë (në lidhje me objektin e tenderit).
- Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 79, pika 1 ku citohet se: "Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë", si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit".

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

2.2.Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Kopje te deklaratave te xhiros vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së parashikuar te kontrates.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" në të cilin gjejmë te përcaktuar se: " *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës*", në pikat 1,2 (b) ,3 të nenit 43, si dhe në nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,. Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të madhe se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e nënshkruar, vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77(c) të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi, ose marrëveshje bashkëpunimi me prodhuesin, ose autorizim distributori për tregtimin e mallrave objekt prokurimi në territorin e RSH. Në rastin e autorizimit të distributorit, duhet paraqitur dhe marrëveshja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë:19.05.2021,“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Ky kriter është vendosur për të garantuar sigurinë e origjinës dhe cilësisë. Autorizimi provon që ofertuesi furnizohet nga burim zyrtar dhe që është produkt origjinal dhe jo i falsifikuar. Gjithashtu autorizimi është kërkuar dhe për t’i dhënë siguri AK-së se mallrat e ofertuar i përmbushin specifikimet teknike të kërkuara.

2.5 Operatori ekonomik të paraqesë katalogë / broshurë / skedë teknike të prodhuesit për artikujt objekt prokurimi ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalog / broshurë / skedë teknike (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Specifikimet Teknike, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria e tyre me dokumentet e tenderit. Dokumenti duhet të jetë në gjuhën shqipe ose i përkthyer dhe noterizuar në gjuhë shqipe.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”nenit 40, pika 6, gërma b,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: fotografitë apo katalogët teknikë”*

Vendosja e kriterëve për paraqitjen e katalogëve/broshurave dhe specifikimeve teknike për tabelat rrugore dhe bojën akrilike është bërë me qëllim garantimin e cilësisë, sigurisë dhe përputhshmërisë së produkteve me standardet në fuqi.

Së pari, sinjalistika rrugore është element kritik për sigurinë e përdoruesve të rrugës (drejtues mjetesh dhe këmbësorë). Për këtë arsye, materialet e përdorura duhet të kenë karakteristika të verifikueshme si:

- rezistencë ndaj kushteve atmosferike (diell, shi, temperatura ekstreme),
- jetëgjatësi të lartë,
- dukshmëri optimale (sidomos natën dhe në kushte të vështira atmosferike),
- përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Së dyti, kërkesa për katalogë, broshura apo skeda teknike nga prodhuesi shërben për:

- identifikimin e saktë të produktit që ofrohet,
- verifikimin e parametrave teknikë (p.sh. reflektueshmëria e tabelave, përbërja dhe qëndrueshmëria e bojës akrilike),
- shmangien e produkteve jo cilësore apo të falsifikuara,
- krahasimin objektiv të ofertave nga operatorë të ndryshëm ekonomikë.

Së treti, dokumentimi i tillë rrit transparencën dhe besueshmërinë e procesit të prokurimit, duke siguruar që kontrata të lidhet me operatorë që ofrojnë produkte që plotësojnë realisht specifikimet teknike të kërkuara.

Gjithashtu, kërkesa që dokumentacioni të jetë në gjuhën shqipe ose i përkthyer dhe i noterizuar garanton:

- kuptueshmëri të plotë nga autoriteti kontraktor,
- shmangie të keqinterpretimit të të dhënave teknike,
- bazë të qartë për verifikim gjatë fazës së vlerësimit dhe zbatimit të kontratës.

2.6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të mallrave, në adresën e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Ky deklaram kërkohet për t’i vërtetuar dhe garantuar AK-së realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi gjithashtu edhe sepse AK nuk ka parashikuar kosto të tjera shtesë.

2.7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku garanton cilësinë e tabelave të sinjalistikës rrugore, për një periudhë prej 12 muajsh nga data e marrjes në dorëzim. Gjatë kësaj periudhe, çdo defekt në material, ngjyrë, reflektim do të riparohet ose zëvendësohet pa kosto nga ana e operatorit ekonomik.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Ky kriter është vendosur në funksion të sigurimit të cilësisë dhe qëndrueshmërisë së mallrave objekt prokurimi. Tabelat rrugore janë të ekspozuara ndaj kushteve të ndryshme atmosferike dhe konsumit të vazhdueshëm, çka kërkon që ato të ruajnë karakteristikat e tyre funksionale gjatë përdorimit.

Kërkesa për garanci 12-mujore synon:

- të sigurojë që produktet e furnizuara janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara,
- të garantojë ruajtjen e parametrave thelbësorë si integriteti i materialit, cilësia e ngjyrës dhe niveli i reflektimit,
- të mbrojë interesin publik dhe fondet publike nga furnizime me cilësi të dobët,
- të vendosë përgjegjësi të qartë mbi operatorin ekonomik për cilësinë e produkteve të ofruara.

Për më tepër, detyrimi që gjatë periudhës së garancisë çdo defekt në material, ngjyrë apo reflektim të riparohet ose zëvendësohet pa kosto nga operatori ekonomik, siguron funksionalitet të pandërprerë të sinjalistikës dhe shmang kosto shtesë për autoritetin kontraktor.

Ky kriter është në përputhje me parimet e proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit, pasi periudha 12-mujore e garancisë konsiderohet standarde për mallra të kësaj natyre dhe nuk kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Ofertuesi i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe brenda afatit të përcaktuar në kërkesën për dorëzim dokumentacioni pranë AK, dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të parashikuara në pikën 2 të nenit 26 të VKM-se 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT